

DEKRET
Nr.203, datë 5.6.1992

PËR DEKLARIMIN E VERIFIKIMIN E FITIMEVE TË REALIZUARA

Në mbështetje të nenit 28, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

DEKRETOJ:

1. Të gjithë shtetasit shqiptarë e të huaj që janë regjistruar si persona fizikë e juridikë në organet kompetente, të deklarojnë në organet financiare burimet e kapitalit fillestar dhe fitimet e realizuara nga data 1.1.1990 e deri ditën e deklarimit.

2. Nëpunësit e shtetit të deklarojnë në organet financiare pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që kanë vënë gjatë periudhës së mësipërme si: ndërtesa, dyqane, depo, troje, makina, valutë etj. dhe burimet e sigurimit të tyre.

3. Organet e kontrollit dhe ato që janë ngarkuar për privatizimin e ekonomisë shtetërore të verifikojnë vlerësimin e pasurisë së shitur dhe për rastet që shitjet janë bërë haptaz në dëm të shtetit, në kundërshtim me ligjin ose për të mashtruar ligjin, të kërkojnë në gjykatë pavlefshmërinë e tyre në bazë të nenit 25 të Kodit Civil.

4. Organet e financës e të kontrollit të verifikojnë zbatimin e rregullave në dhënien e autorizimeve për shitjen e pasurisë shtetërore dhe, kur konstatojnë shkelje ligjore, të vendosin anulimin e tyre.

5. Organet e financës e të kontrollit të verifikojnë zbatimin e rregullave të dhënies e të zbatimit të licensave për ushtrimin e veprimtarisë private dhe kur gjejnë parregullsi t'i anulojnë ato dhe të marrin masat e parashikuara në ligj.

6. Komisioni i Kontrollit të Shtetit, organet e kontroll-revizionit financiar të komiteteve ekzekutive të rretheve, si dhe Ministria e Bujqësisë të rishikojnë vlerësimin dhe ndarjen e pasurisë së ish-kooperativave bujqësore dhe, kur vërejnë raste të shpërdorimeve, vjedhjeve, privatizimit në dëm të interesave të grupit apo individëve të këtij grupi, të marrin masat e parashikuara në këtë dekret dhe çdo masë tjetër të parashikuar nga ligji për mbrojtjen e interesave publike dhe të të drejtave të pronarëve.

7. Këshilli i Ministrave t'u caktojë detyrat konkrete organeve vartëse për zbatimin e këtij dekreti dhe në muajin shtator të analizojë gjendjen. Përfundimet e analizës të raportohen në Kuvendin Popullor.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha